

“Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare”

Përmbledhje e ideve dhe argumentave të studentëve debatues

Ky raport është përgatitur nga ekspertja e SCiDEV, Nevila Xhindi, me kontribut nga studentët lider të skuadrave debatuuese, si edhe nga Megi Ruka, Adela Danaj, Lutjona Lula, Orkidea Xhaferaj, nën kujdesin e përgjithshëm të Blerjana Bino.

Tiranë, Qeshor 2020

Projekti “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare”, u zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) nga 21 tetor 2019 – 30 Qeshor 2020 në Tiranë dhe Durrës.

TABELA E PËRMBAJTJES

Qëllimi i raportit	4
Përmbledhje e projektit	4
Përgjegja e SCiDEV ndaj COVID19	6
Projekti i përshtatur në kushtet e pandemisë.....	7
Ri-dimensionimi i rregullave dhe zhvillimit të debatit si rezultat i COVID-19	8
Trajtimi i çështjeve të Integritit në turnamentin e debatit universitar.....	9
Mësimet nga debatet online	10
Idetë dhe argumentet e studentëve.....	11
Përfundimi dhe rekomandime	21

Qëllimi i raportit

Qëllimi i këtij raporti është që të bëj një përmbledhje të rezultateve të projektit “Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare”, zbatuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA). Në mënyrë të veçantë raporti ndalet tek përshtatja e projektit në kushtet e pandemisë COVID19 dhe prezantimi i ideve dhe argumenteve kryesore të studentëve lidhur me tematikat kryesore të debatit për integrimin europian të Shqipërisë. Raporti prezanton edhe rekomandime për mënyrën sesi duhet të zhvillohet më tej debati universitar lidhur me integrimin europian dhe tema të tjera me interes për të rinjtë si edhe për shoqërinë shqiptare në tërësi.

Të dhënat e raportit janë mbledhur përmes analizës së dokumenteve të projektit, zbardhjes së takimeve online që ka realizuar projekti si dhe të debateve përmes përmbledhjes së ideve kryesore nga vetë studentët. Kështu ky raport paraqet edhe një përpjekje për të dokumentuar njohurinë dhe përvojën e krijuar nga ky projekt duke krijuar një bazë të mirë për të ndërtuar projekte të tjera në të ardhmen.

Përmbledhje e projektit

Integrimi europian është prioriteti më strategjik i shtetit Shqiptar dhe rrjedhimisht prek thuajse të gjitha fushat, përfshi këtu edhe atë të arsimit dhe të të rinjve. Nga qershori i viti 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në BE. Megjithatë, kriteret e vendosura nga Bashkimi Europian për anëtarësim janë parakushte për kalimin e fazës tjetër të procesit, i cili është ai i hapjes së negociatave, vendim i cili pritet në tetor 2019. Ndërkohë që Qeveria Shqiptare dhe aktorët e tjerë politikë përgatiten për procesin e hapjes së negociatave, duket se është e rëndësishme edhe ekzistenca e një debati publik të shëndetshëm lidhur me procesin, përfitimet, kostot dhe në tërësi ndikimi që do të ketë integrimi për Shqipërinë. Arsimi dhe të rinjtë mund dhe duhet të luajnë një rol në këtë proces. Nevoja për zhvillimin cilësor të arsimit të lartë në Shqipëri është tashmë e mirëpranuar nga të gjithë aktorët.

Zhvillimi i aftësive analitike dhe kritike të studentëve dhe kërkuesve të rinj është pjesë përbërëse e objektivit final për një arsim më cilësor. Kultura e debatit, etika e të debatuarit, analiza kritike, aftësitë kërkimore dhe prezantuese janë të gjithë aftësi dhe kompetenca që u nevojiten studentëve dhe kërkuesëve të rinj jo vetëm në akademi por edhe përtej saj në përgatitje për tregun e punës. Duke marrë shkas nga dinamikat të cilat derivojnë si rezultat i përpjekjeve për antarësim, Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipëri.

(OSFA), inicioi projektin ‘Laboratori i debatit mbi integrimin evropian në auditorët universitare’ në 21 tetor 2019.

[Projekti](#) synoi (i) të përforcojë njohuritë dhe të promovojë kulturën e debatit, kultivimin e analizës dhe të menduarit kritik, etikën në komunikim, tolerancën dhe vlera të qytetarisë aktive në Shqipëri tek studentët dhe kërkuesit e rinj lidhur me Integrimin Evropian dhe (ii) ndikimin shumëdimensional të tij në Shqipëri përmes organizimit të turnamentit të debatit në auditorët universitare. Për realizimin e qëllimive të këtij projekti, u nxit përfshirja e një rrjeti të gjerë bashkëpunëtorsh, pjesë e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri. Pedagoët dhe studentët pjesëmarrës në projekt, fillimisht ishin subjekt i procesit të aplikimit si përgjigje ndaj thirrjes për aplikim nga SCiDEV. Secili institucion i arsimit të lartë i përfshirë në projekt, u përfaqësua nga një pedagog, ekspert i fushës dhe studimeve mbi Bashkimin dhe Integrimin Evropian si dhe nga tetë studentë, të cilët kompozuan dy grupet në kokurrim në debatin ‘Laboratori i debatit mbi integrimin evropian në auditorët universitare’. Universitetet e përfshira në këtë projekt ishin:

1. Fakulteti i Biznesit, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FE/UAMD)
2. Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD)
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT)
4. Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT)
5. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT)
6. Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT)
7. Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT)
8. Universiteti Evropian i Tiranës (UET)
9. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)
10. Universiteti Neë York i Tiranës (UNYT)
11. Kolegji Universitar Marlin Barleti (MB)
12. Kolegji Universitar Luarasi (Luarasi)
13. Universiteti i Epokës (Epoka)

Qëllimi dhe objektivat e projektit u menduan të realizohen përmes (i) organizimit të një seti trajnimesh për 13 pedagogë nga 13 universitete publike dhe private lidhur me kulturën dhe formatin e debatit; (ii) organizimin e një seti trajnimesh për 104 studentë dhe kërkues të rinj nga 13 fakultete/universitete publike dhe private për mënyrën e realizimit të debatit dhe aftësitë debatuese; (iii) organizimin e turnamentit të debatit në auditor me 13 debate universitare dhe 1 debat kombëtar. Për shkak të kushteve të krijuara si rezultat i pandemisë COVID-19, turnamentet e debatit në auditor u pezulluan,

me rast përjashtimor, Universitetin Mesdhetar dhe të Shqipërisë dhe Universitetin Marin Barleti të cilët e zhvilluan eventin para datës 12 Mars 2020, datë e cila shënon dhe kushtëzimin e aktiviteteve dhe ritmit të përditshëm. Ndërkohë trajnimet e pedagogëve dhe studentëve të përfshirë në projekt u realizuan sipas harkut kohor të parashikuar.

Përgjegja e SCiDEV ndaj COVID19

Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV) respektoi masat e distancimit fizik, me qëllim parandalimin e përhapjes së virusit në kuadër ta pandemisë COVID-19 sipas udhëzimeve përkatëse në fuqi. Në kuadër të masave të ndërmarra nga data 12 mars 2020 stafi i SCiDEV është duke punuar online për vijimësinë e aktiviteteve dhe projekteve. Për t'ju përshtatur sa më mirë situatës, komunikimi me partnerët dhe bashkëpunëtorët vijoi përmes platformave alternative të komunikimit, duke mundësuar progresin e punës në përfitim të shoqërisë.

Fillimisht, SCiDEV nisi një [deklaratë](#) lidhur me situatën dhe me përgatitjet e marra nga organizata duke garantuar partnerët, donatorët dhe bashkëpunëtorët si edhe përfituesit për vazhdimësinë e punës, edhe pse në kushte të reja. SCiDEV kishte parashikuar të zhvillonte turnamentin e debatit mes muajëve Mars-Prill 2020, në kuadër të projektin 'Debati për Integrimin Europian në Auditorët Universitar' me mbështetjen e Fondacionit për Shoqëri të Hapur në Shqipëri (OSFA). Gjatë kësaj periudhe do të organizoheshin debatet universitare në 11 institucione të arsimit të lartë. Ndërkohë që debatet në dy institucione ishin realizuar në [Dhjetor 2019](#) dhe [Shkurt 2020](#).

Pas shpalljes së kushteve të reja, SCiDEV u përqendrua në përshtatjen e projektit sipas situatës së re dhe realizoi në 8 javë këto aktivitete të reja, të paparashikuara në projekt aplikim ose të përshtatura plotësisht me situatën e re:

- ⇒ Nisma '[#QëndronëShtëpi #QëndroAktiv](#)', ku ftoi të gjithë studentët dhe pedagogët pjesë të projektit të debatit të ndanin përmes fotove apo mesazhe pozitive se si po e shfrytëzonin periudhën e izolimit. Studentët dhe stafi kanë qenë aktiv dhe rregullisht janë publikuar mesazhet e tyre.
- ⇒ Studentët u ftuan të përgatisnin [video mesazhe](#) për të rritur ndërgjegjësimin për situatën, për të shprehur përshtypjet e tyre dhe përvojën në vetë-izolimim apo me mësimin online. Këto u publikuan në rrjetet sociale në formën e kolazheve të videove dhe gjenden [këtu](#), [këtu](#) dhe [këtu](#) si dhe [këtu](#).
- ⇒ Gjatë periudhës së izolimit në mënyrë të veçantë është punuar me rubrikën e [BLOG](#) si një ndër aktivitetet e projektit. Ndërkohë që në projekt ishin parashikuar vetëm publikimi i 13 artikujve nga pedagogët, ndërkohë që si rezultat i kushteve të krijuara, Rubrika Blog u shndërrua si portal

mes pedagogëve, edhe studentëve, si edhe ekspertëve apo të tjerë të interesuar që nuk ishin pjesë e projektit. Skuadra e projektit, pedagogët mentorë dhe studentët kanë qenë aktiv edhe përmes publikimit të shkrimeve mbi tema që lidhen jo vetëm me integrimin europian, por edhe me aktualitetin: si ka ndryshuar realiteti ku punojmë e studiojmë nga pandemia. Një prej pedagogëve publikoi një analizë të avantazheve dhe disavantazheve të organizimit të debateve online, që gjendet [këtu](#).

- ⇒ Organizimi i webinarit “Qasja e BE-së ndaj pandemisë Covid19”. Në këtë webinar u bashkëbisedua me ekspertët dhe me pjesëmarrësit rreth qasjes së Bashkimit Europian ndaj krizës së shkaktuar nga pandemia COVID19. A ka qenë e unifikuar përgjigja e BE-së? A është reaguar në kohë? A po lindin ndasi të reja? Apo kriza e COVID19 do të shërbejë për solidaritet dhe bashkëpunim edhe më të thellë? Si ndikon kjo procesin e integrimin europian për Shqipërinë dhe rajonin? Regjistrimi i plotë [këtu](#).
- ⇒ Në kushtet e pandemisë COVID-19, SCiDEV në dakordësi me grupin e pedagogëve dhe OSFA vendosën shtyrjen e debateve të planifikuara për një datë të dytë. Me qëllim që të përgatiteshim për mundësinë e zhvillimit të debateve apo aktiviteteve të tjera online dhe për të marrë mendimet e studentëve dhe pedagogëve në mënyrë të strukturuar, SCiDEV në bashkëpunim me OSFA ndërroi një [pyetësor](#) për të vlerësuar kapacitetet dhe mundësitë që kanë studentët pjesëmarrës për të arritur rezultatet e projektit përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në kushtet e reja të vetë-izolimit dhe distancimit shoqëror si pasojë e pandemisë COVID-19.
- ⇒ [Gjetjet e pyetësorit](#) shërbyen për të informuar vendimmarrjen e SCiDEV lidhur me realizimin e debateve apo aktiviteteve të tjera online.
- ⇒ SCiDEV publikoi një [raport të plotë](#) lidhur me analizën e gjetjeve duke përfshirë edhe rekomandimet përkatëse për masat për të bërë të mundur përfundimin me sukses të projektit.
- ⇒ SCiDEV organizoi [trajnimin](#) e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, online si edhe diskutoi për mundësitë e formatit online të debatit. Trajnimi u regjistrua dhe shërbeu si një instrument për këdo që është i interesuar për të mësuar rreth debatit të strukturuar.
- ⇒ SCiDEV përpiloi gjatë periudhës 15 - 20 qershor dokumentin e politikave që po parashtrohet në këtë raport.

Projekti i përshtatur në kushtet e pandemisë

Duke synuar përfshirjen maksimale të të rinjve në debat si dhe mbarëvajtjen dhe përmbushjen e qëllimit dhe objektivave të projektit, SCiDEV dhe OSFA, menduan forma alternative mbi realizimin e turnameteve të debatit nën kushtet e reja të krijuara prej COVID-19. Kështu, debatet e projektit 'Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare' u realizua përmes platformave alternative të komunikimit të sugjeruara nga zhvillimet teknologjike. Ndryshimi i kushteve u shoqërua dhe me disa ndryshime në lidhje me (i) mënyrën e organizimit të turnamentit të debatit; (ii) përfshirjen dhe përqëndrimin e SCiDEV në përshtatjen e projektit sipas situatës së re të krijuar duke realizuar aktivitete të reja; (iii) përmbledhje e argumentave kryesorë të trajtuar gjatë turnamentit të debatit mbi 'Integrimin e Shqipërisë në BE' si reflektime mbi mënyrën se si COVID -19 impaktoi kushtet e jetesës dhe organizimin dhe përmbajtjen e temave të debatit. Turnamenti virtual u zhvillua gjatë harkut kohor 25 Maj – 11 Qershor 2020.

Ri-dimensionimi i rregullave dhe zhvillimit të debatit si rezultat i COVID-19

Ndryshe nga sa ishte parashikuar, në turnamentin virtual u përfshinë në kokurrim vetëm skuadrat në nivel Universiteti/Fakulteti nga ku nuk u shpall nje skuadër fituese e cila do t'i duhej të debatonte më skuadrën fituese të një Universiteti/Fakulteti tjetër të përfshirë në projekt e deri në kualifikimin e dy skuadrave finaliste të cilat do të debatnin në nivel kombëtar. Kjo zgjedhje erdhi si pasojë e disa arsyeve. Së pari kushtet e reja të krijuara prej pandemisë COVID-19, ndoshta do të rëndonin më shumë psikologjikisht studentët e përfshirë në kokurrim nëse do të zgjidhnim fitues mes tyre dhe së dyti, nga pikëpamja logjistike dukej e vështirë realizimi i një set debatesh virtual. Ky organizim i ri kërkoi ri-dimensionimin e formatit të debatit për të cilin u zhvillua një seancë e re trajnimit virtual. Formatit i ri parashikoi dhe u realizua përmes:

- Pjesëmarrjes së 2 skuadrave të universitetit plus i hapur për dëgjues të tjerë
- Përfshirjen e një 1 moderatori për debatin – pedagogu mentor me mbështetje SCiDEV
- Liderët e skuadrave përkatëse debatuan me njëri tjetrin për 20 minuta duke mbrojtur tezat pro dhe kundra, por duke iu përgjigjur pyetjeve që ngre moderatori
- 20 minuta u parashikuan për diskutime me inpute nga pjesëmarrësit
- 10 minuta u hartuan dhe zhvilluan përfundimet nga pedagogu përkatës që ka qenë edhe mentori i grupit
- Skuadrat punuan më pas të nxjerrin me shkrim argumentat / tezat e tyre në formën e një analize të shkurtër me rekomandime që po përmbledhen në këtë raport.

Formati i ri i debatit, sikurse më lart, nuk parashikoi skuadra/skuadër fituese, por 'leaders' të të dy grupeve u pajisën me një kupon ku përfitonin disa libra shuratë. Ndërkohë 'leaders' e skuadrave u zgjedhën nga vetë anëtarët e skuadrave të debatit. Të gjithë studentët debatues u pajisën me Certifikata

pjesëmarrjeje. Udhëzimet e plota të formatit gjenden [këtu](#) si edhe paketa kërkimore e përditësuar me burime për ndikimin e COVID19 gjendet [këtu](#).

Trajtimi i çështjeve të Integritit në turnamentin e debatit universitar

Në debatin virtual krahas temave të gjeneruara paraprakisht me fokus Integrimin e Shqipërisë në BE, u trajtuan dhe tema të cilat kishin lidhje me kushtet e reja dhe si këto të fundit u reflektuan në nivelin Evropian; marrëdhënien mes vendeve të BE-së; impaktin që patën tek qytetarët Evropian; impaktin që patën në narrativën politike dhe mes qytetarëve në Shqipëri në lidhje me intergrimin në BE. Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti por dhe ndryshimeve që ndodhën, u krijuan hapësira për reflektime apo debate mbi të ardhmen e BE-së dhe kryesisht mbi të ardhmen e Shqipërisë si shtet kandidat për anëtarësimin në BE.

Skadrat debatuan sipas këtyre temave:

TEMA	UNIVERSITETI/FAKULTETI
'Integrimi evropian thellon dhe përmirëson demokracinë në Shqipërisë'	Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FSHJP/UAMD) Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës (ISE/UT) Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës (FSHS/UT) Universiteti Marin Barleti (UMB) – debat fizik
'Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian rrezikon të ardhmen e produkteve dhe shërbimeve vendase'	Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (FE/UT) Universiteti Neë York i Tiranës (UNYT)
'Anëtarësimi në Bashkimin Europian sjell zhvillim ekonomik për vendin'	Fakulteti i Biznesit, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (FE/UAMD) Universiteti i Epokës (Epoka)
'Lëvizja e lirë në Bashkimin Europian për të jetuar, për tu arsimuar dhe për të punuar do të shkaktojë krizë demografike në Shqipëri'	Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FD/UT) Kolegji Universitar Luarasi (Luarasi)
'E ardhmja e Bashkimit Europian është zgjerimi, jo thellimi'	Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës (FHF/UT) Universiteti Europian i Tiranës (UET) Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) – debat fizik

Pyetjet në secilin debat ndryshonin në varësi të dinamikës së debatit dhe drejtoreshin nga pedagog mentorues dhe moderator. Disa pyetje ishin të përbashkëta për të gjithë debatet pasi lidheshin me impaktin e perceptuar të COVID19 në tematikat e trajtuara:

- Si ka ndikuar roli i Delegacionit të BE-së dhe zyrtarëve të tjerë të lartë të BE-së sa i takon demokracisë së brendshme në Shqipëri?
- Tani që u hapën zyrtarisht negociatat, a mendoni se roli i BE-së për të nxitur zhvillimin demokratik në vend ka përfunduar?
- Si duhet të përgatitet Shqipëria për të përballuar konkurrencën me produktet dhe shërbimet me standarde europiane?
- Si mund të përmirësohet zhvillimi ekonomik në vend?
- A është në krizë demografike Shqipëria edhe tani?
- Si ndikon populizmi në këtë drejtim?
- Si ka ndikuar kriza e pandemisë COVID19 në temën në diskutim?

Në seksionin e mëposhtëm paraqiten në mënyrë të detajuar një përmbledhje në lidhje me temat dhe argumentat që u diskutuan gjatë realizimit të turnamentit të debatit dhe si u reflektua në debat elementi 'pandemia COVID-19'. Përmbledhjet janë hartuar të kategorizuara sipas Universitetit apo Fakultetit të përfshirë në projekt. Përmbledhja është hartuar mbështetur në eksperiencën e formatit virtual.

Mësimet nga debatet online

Përvoja e SCiDEV me organizimin e debateve online rezultoi pozitive në disa aspekte të rëndësishme:

- fleksibiliteti i mjedisit virtual që studentët të bashkoheshin në debat pavarësisht vendndodhjes së tyre fizike;
- mundësia për të tjerë të interesuar të bëheshin pjesë lehtësisht e debatit;
- angazhim i studentëve në kërkimin e mëtejshëm të temave të debatit me fokus ndikimin nga COVID19 apo implikimet nga situata e re e krijuar në Shqipëri dhe në botë;
- studentët mësuan forma të reja të komunikimit dhe ndërlidhjes si edhe përdorimin e platformave të ndryshme që mundësojnë këtë online;
- studentët dhe pedagogët bashkëpunuan më shumë me njëri tjetrin në një format të ri dhe pedagogët ofruan mbështetje psiko-sociale për studentët që mentoronin.

Megjithatë, debatet online kanë disa mangësi krahasuar me debatet fizike në formatin e parashikuar fillimisht nga projekti:

- kërkohet që studentët të kenë akses në Internet dhe të jenë të pajisur me pajisjet e nevojshme elektronike dhe kjo nuk është gjithmonë e mundur duke rrezikuar përjashtimin e atyre që janë më pak të avantazhuar si në aftësi edhe në akses dhe burime;
- pasiguria e lidhur me situatën e COVID19 rëndoi gjendjen psikologjike të tyre dhe uli interesin për angazhim e tyre;
- shpirti i skuadrës dhe bashkëpunimi shpesh dobësohej përshkak të mungesës së ndërveprimit konkret;
- në kushtet kur studentët duhet të ndiqnin leksione online, të përgatiteshin për provime apo tema diplome / detyra kursi, u kërkohet edhe përgatitja për debatet online me format të ndryshuar.

Edhe përmes formatit online, projekti arriti që të përforcojë tek studentët:

- mendimin kritik, kjo vihet re edhe në analizat dhe shkrimet e tyre për rubrikën Blog si edhe në nivelin e argumentave që paraqitën në debat;
- tolerancën për mendimin ndryshe që vihej re përgjatë të gjithë debateve;
- përmirësim të etikës së komunikimit dhe elementëve të lidhur me të;
- aftësitë kërkuese që vihet re në shqyrtimin e burimeve dhe raporteve të reja lidhur me COVID19 dhe BE-në.

Projekti tregoi mbi të gjitha është dëshmi e aftësisë së studentëve për tu përshtatur dhe ecur përpara (resilience), për tu treguar solidarë dhe për të mbështetur njëri tjetrin si edhe për të dhënë mesazhe ndërgjegjësuse për të tjetrët duke paraqitur edhe ide dhe zgjidhje inovative.

Idetë dhe argumentet e studentëve

Idetë dhe argumentet paraqiten në mënyrë kronologjike sipas realizimit të debatit. Videot e plota gjenden [këtu](#).

⇒ Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Debati Universitar për Integrimin u zhvillua në datë 17 Dhjetor 2019, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, duke çelur kështu serinë e debateve universitare në Tiranë dhe Durrës. Ky aktivitet erdhi si një sinergji mes këtij projekti dhe projekti “Të rinjtë drejt Europës”, mbështetur nga fondet IPA të Bashkimit Europian, zbatuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.

Debati u organizua edhe si një takim i hapur me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë si edhe pjesëmarrësve nga institucionet e tjera universitare. Debati i parë u fokusua në temën 'Migrimi dhe Integrimi European' nën kujdesin e Dr. Kriton Kuçi. Të dyja skuadrat sollën shifra dhe raporte nga burime ndërkombëtare për të mbështetur tezat e tyre. Gjithshtu, studentët theksuan nevojën për një shoqëri europiane të hapur dhe gjithëpërfshirëse duke dakordësuar për emigracionin si një mënyrë për të rigjeneruar shoqëritë europiane në plakje, por paraqitën plane të ndryshme për mënyrën sesi duhet adresuar emigracioni dhe për impaktin që ka në Europë.

⇒ **Universiteti Marin Barleti**

Debati Universitar për Integrimin u zhvillua në datë 28 shkurt 2020, në Universitetin Marin Barleti. Dy skuadrat e Universitetit Marin Barleti debatuan rreth temës “Integrimi European thellon dhe përmirëson demokracinë në Shqipëri” nën kujdesin e Dr. Eurona Leka dhe Dr. Esmeralda Hasani. Të dyja skuadrat sollën argumenta lidhur me ndikimin e integritit europian në demokracinë në Shqipëri. Gjithashtu, studentët debatuan edhe rreth një teme të dytë pa pasur përgatitje fillestare. Në finale, vlerësimi u bazua në kriteret si etika, komunikimi dhe forca e argumentit dhe kundër-argumentit.

⇒ **Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës**

U zhvillua në datë 27 Maj, debati mbi Integrimin European në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *‘Integrimi European thellon dhe përmirëson demokracinë në Shqipëri’*, nën moderimin e Dr. Elda Zotaj e Lutjona Lula. Në këtë format debati studentët e Fakultetit Juridik të Shkencave Politike dhe Juridike, debatuan me tezat pro dhe kundër të kategorizuar në dy grupe. Argumentet pro dhe kundër ku u përqëndrua kryesisht debate ishin:

Agrumentet Pro: Reformimi total i strukturave që procesi bënë vendeve candidate të cilat mbështeten dhe në teori.

Argumentet Kundër: Mbështetet nga raportet ndërkombëtare, problemet që BE gëzon së brendëshmi, pandemia Covid-19 dhe qasja e tyre në një moment specifik për Bashkimin European dhe vendet kandidate.

Ndërkohë, në përfundim të webinar, moderatore Lutjona Lula solli një përmbledhje të diskutimit:

“Lidhur me argumentat dhe mënyrën e qasjes së tyre mendoj se nuk u pasqyruan qartë. Duhet patur parasysh se si student që jeni sfida kryesore të qëndroni besnik me kauzën dhe nëse ju nuk e përqaftoni atë në të vërtetë. Me rëndësi është përdorimi i vazhdueshëm i evidencave për të qënë sa më konkret, pasi po debatojmë idetë dhe qendrojmë larg sulmeve personale. Në vijim lutem të keni parasysh retorikën që përdorni në këto formate të strukturuar Debati. Ju nxis ta përdorni sa më fort aktivizmin tuaj rinor dhe të bëheni pjesë e të tilla iniciativave.” - përfundoi ajo.

⇒ **Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës**

U zhvillua në datë 28 Maj, debati mbi Integrimin European në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *‘E ardhmja e Bashkimit European është zgjerimi, jo thellimi’*, nën moderimin e Dr. Meljana Bregu, mentore dhe Anisa Curraj.

Skuadra Pro: solli një përshkrim historik të themelimit të BE-së dhe politikat më të suksesshme të zgjerimit të BE ndër vite.

Skuadra Kundër pohoi se: thellimi sjell të ardhmen e BE, kjo bazuar në krizën institucionale të evidentuar, rritjen e nivelit të borxhit publik dhe Brexit.

Dr. Meljana Bregu:

“Si një europeaniste mendoj se thellimi do duhet të ketë më shumë peshë, mendoj se iniciativa të tilla janë shumë positive për të shprehur mendimet tuaja si të rinj.”

⇒ **Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës**

U zhvillua në datë 29 Maj, debati mbi Integrimin European në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *‘E ardhmja e Bashkimit European është zgjerimi, jo thellimi’*, nën moderimin e Dr. Klodiana Beshku, mentore dhe Prof. As. Dr. Nevila Xhindi.

Në fjalën e saj, Prof. Asoc Dr. Nevila Xhindi tha:

“Duhet të theksoj se si dëgjuese e këtij debati, ne në vend dhe mes të rinjsh nuk e kemi mësuar ende detyrën e shtëpisë. Demokracia nuk gjendet mes nesh apo nuk blihet, ajo vjen si pasojë e një serë procesesh. Nga pikëpamja empirike nuk ka asgjë që e garanton demokracinë apo natyrën e saj, pasi mbi të gjitha ajo është një detyrë jona. Ne të gjithë kemi fanar ndricues si Europa, ne pamë sesi Covid-19 vertetoi se kjo e fundit është tepër e brishtë. Ne gjendemi përpara një Europe të lodhur, jo vetëm nga ana e reformave por dhe zgjerimit. Ky ishte mesazhi që do doja të dëgjoja më qartë nga ju. Nga ky debat si nga grupi konfirmues apo dhe nga ai kundështues arrita të evidentoj se të gjithë problematikat kanë të njëjtin bosht dhe këto lidhen me të qënurit e një shteti demokratik ose jo. Demokracia në Shqipëri nuk duhet të jetë një dhuratë, por një punë e vazhdueshme jona. Hapja e negociatave duke marrë parasysh dhe situatën e momentit mund të marr një kohë të papërcaktuar. Nga ana tjetër na janë vendosur disa kushte më të forta për tu bërë pjesë e BE, duhet të zgjidhim këto detyra që më pas ne të japim rezultate positive.”

Ndërkohë argumentat kryesore sipas skuadrave ishin:

Orges (Student):

“Slogani post komunizmit ishte “e duam Shqipërinë si gjithë Europa”, tashmë kemi bërë disa hapa pranë BE dhe me hapjen e negociatave. Demokratizimi i partive politike është kryesor për ecurinë e shtetit. Kjo sjell një rritje të besimit ndër qytetarë. Siç e dimë reforma zgjedhore është me rëndësi, transparenca dhe legjislativi, kjo për të reduktuar korrupsionin. BE kërkon zgjedhjen e problemeve me anë të dialogut, sipas rekomandimeve të dhëna. Mendoj se komunikimi dhe hapja me Europën nxit demokracinë.”

Elion Osmani (Student):

“Demokracia e konsoliduar për tu integruar në Bashkimin European ende mungon. Nuk mund të krahasojmë një vend me GDP si Shqipëria me vendet e tjera të komunitetit european. Reforma në drejtësi nuk ka funksionuar, mendohet se ajo do të luftoj korrupsionin por sjell vetëm problematika për sa kohë nuk kemi një Gjykatë Kushtetuese. Procesi i Europeanizimit në vende si Shqipëria mendoj se kërkon një komandim, për sa kohë një vend si yni ka problematika të shtetit demokratik. Ndaj ndjekja e këtij procesi është e vështirë. Gjatë gjithë viteve të tranzicionit, partitë politike kanë shfaqur problematika dhe mungesë bashkëpunimi në dhënien e zgjidhjes ndaj situatave.”

⇒ **Fakulteti i Ekonomisë Universiteti i Tiranës**

U zhvillua në datë 11 Qershor debati mbi Integrimin European në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *'Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin European rrezikon të ardhmen e produkteve dhe shërbimeve vendase'*, nën mentorimin e Dr. Esmeralda Shehaj dhe moderimin e Lutjona Lula.

Dr. Shehaj u shpreh se studentët dhe pse vijnë nga profile të ndryshme, mblidhen në një tematikë interesante dhe me vend në situatën ku ndodhet vendi. Studentët e FEUT të ndarë në dy skuadra janë do të mbajnë qëndrimet e tyre pro nën përfaqësimin e Fjoralba Lamaj dhe kundër me përfaqësimin e liderit Ilir Basha.

Skuadra Pro- Argumetni kryesor i Fjoralba Lamaj (Student):

'Bashkimi European në thelb ka nisur si një marrëveshje tregtare dhe kjo tregon shumë dhe për tematikën. Në momentin kur Shqipëria do të jetë pjesë e BE, nuk do të kemi më taksa dhe tarifa doganore për mallrat që hyjnë dhe dalin në rajon, ne besojmë se ky është një impakt tejet negativ, kur një vend si yni nuk ka as një ekonomi të shkallës.'

Skuadra Kundër- Argumetni kryesor i Ilir Basha (Student):

'Ne besojmë së anëtarësimi në BE nuk rrezikon të ardhmen e produkteve vendase. Do doja të sjell në vëmendjen tuaj anëtarësimin në BE të shteteve si Rumania dhe Bullgaria, niveli eksportit të tyre para dhe pas anëtarësimit në BE është rritur me nivele shumë përfaqësuese. Po ashtu duke marrë parasysh rastin e Kroacisë, i cili është shteti i fundit i anëtarësuar në BE, vëmë re se ndryshimet në eksport para dhe pas anëtarësimit është rritur me një shifër tepër domethënëse mbi 28%. Shqipëria është një vend tepër strategjik, ndaj anëtarësimi në BE do të na bëjë një vend më të sigurt dhe për turistët. Kjo sjell një rritje të eksportit të shërbimeve. Kjo do të sjell hapësira për treg si importi dhe eksporti. Përfitimi që vjen nga anëtarësimi është tepër më i lartë sesa të mos qenit pjesë e këtij unioni.'

Lutjona Lula:

'Në përfundim të këtij debati, dua t'ju them me plot bindjen se debati ishte shumë cilësor dhe i strukturuar. Në një rast tjetër, nëse do të kishim qenë në auditor do t'ju thoja me bindje të plotë se do ishit një nga grupet finaliste. Ju përgëzoj dhe mendoj se jeni në rrugën e duhur, debati ishte tepër interesant dhe pse kaluam pak kohën e parashikuar. Argumentet që keni sjell dhe përdorimi i referencave mbi to i jep tepër cilësi debatit.'

Dr. Esmeralda Shehaj:

‘Në kushte të tjera mendoj se debati do të kishte përmirësuar dhe më shumë aftësitë e studentëve. Në fund të ditës ky debat dhe konkurrenca ju ka bërë të thelloheni në argumente dhe ju ka ndihmuar në përdorimin e aftësive tuaja. Në përfundim do falënderoja organizatën implementuese SCIDEV dhe organizatën financuese OSFA.’

⇒ **Universiteti EPOKA**

U zhvillua në datë 11 Qershor debati mbi Integrimin European në Universitetin Epoka. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën “Anëtarësimi në Bashkimin European sjell zhvillim ekonomik për vendin”, nën moderimin e Dr. Tea Hodaj, mentore dhe Orkidea Xhaferaj. Tema e debatit u zhvillua nga dy grupe studentësh, për skuadrën pro Gledis Hajdari dhe Blerina Dashin për atë kundër.

Skudra Pro- Gledis Hajdari (Student):

‘Lidhur me temën, në diskutime kemi parë anëtarësimin e Shqipërisë në BE si një dritë jeshile. Do ishte tepër pozitive lëvizja e lirë e mallrave dhe njerëzve, po ashtu turizmi për ne është një pikë shumë e fortë. Kemi rastin e produkteve dhe supermarketeve lidhur me të drejtat tregtare. Këtu do përmendja të drejtën e Shëndetit dhe Ekonomisë, është e rëndësishme për vendin anëtarësimi duke marrë parasysh se BE është një nga modelet ekonomike më interesante në botë. Mendoj se integrimi në BE është shumë favorizues për një vend si ne.’

Skudra Kundër- Dejan Cullafiq (Student):

‘Duke ditur se Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Europë, mendoj se ne nuk do të kemi ndonjë përfitim. Lidhur me euron dhe aplikimin e kësaj monedhe, mendoj se çmimi dhe niveli i jetesës do të rritet por qytetarët nuk do mund të kryejnë nevojat bazike. Dicka tjetër vlen të përmendet se të qënurit pjesë e BE do të sillte shumë problematika lidhur me importin dhe eksportin e mallrave. Mendoj se jemi ende shumë herët për tu përfshirë në union.’

⇒ **Instituti i Studimeve Europiane, Universiteti i Tiranës**

U zhvillua në datë 8 Qershor debati mbi Integrimin European në Institutin e Studimeve European, Universiteti i Tiranës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën ‘Integrimi european thellon dhe përmirëson demokracinë në Shqipërisë.’, nën moderimin e Dr. Doris Malaj, mentore dhe Orkidea Xhaferaj, eksperte e politikave publike.

⇒ **Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës**

U zhvillua në datë 10 Qershor debati mbi Integrimin Europian në Fakultetin e Shkencave Juridike, Universiteti i Tiranës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *'Lëvizja e lirë në Bashkimin Europian për të jetuar, për të punuar dhe për tu arsimuar do të shkaktojë krizë demografike në Shqipëri.'*, nën moderimin e Dr. Petrina Broka dhe mentore Megi Ruka. Këto ishin argumentat kryesore që u zhvilluan gjatë seancës së debatit:

Argumenti Pro- Ana Lena (student):

'Do të filloja në shqyrtimin e faktorëve ekonomik, siç është zhvillimi ekonomik dhe rritja ekonomike. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, rritja ekonomike nuk e ka ulur varfërinë. Ndërsa statistikisht Freedom House tregon se korrupsioni në vend është në nivele 2.7% nga 7% në total, pra rezulton se Shqipëria është një vend me regjim gjysëm autoritar të konsoliduar. Po ashtu Instat tregon se më shumë se 1/3 e fëmijëve nuk kanë infrastrukura për të studiuar. Sa i takon indikatorëve të sistemit shëndetësor, vendi ynë ka nivelet më të ulëta në investimin ndaj këtij sektori. Po ashtu anëtarësimi në BE nuk na garanton që këto problematika do të reduktohen pasi janë të pranishme dhe në vendet që janë pjesë e komunitetit europian. Një raport i BIRN tregon se maternitetet shqiptare nuk kanë prezencë inkubatorësh dhe kjo sjell një rritje të nivelit të vdekshmërisë. Po ashtu vihet re një tendencë e studentëve shqiptar drejt orientimit në degë që ofrojnë mundësi emigracioni, të tilla si Infermiera. Kjo identifikohet dhe nga prezenca e këtyre programeve në universiteteve private si Aldent apo Universiteti Europian i Tiranës.'

Argumenti Kundër- Megi Ndregjoni (Student):

'Mungesa e mirëqenies dhe faktori ekonomik janë shumë prezent dhe tregojnë se përse po ndodh kjo krizë demografike. Nëse do të duam të jemi pjesë e Bashkimit Europian do të duhet të përmbushim standardet. Integrimi në BE nuk do të sjelli krizë por përkundrazi do të ndihmojë vendin në sjelljen dhe implementimin e eksperiencave të reja. Nëse ne pretendojmë një problem demografik në këtë moment, mendoj nuk është shumë koherente pasi në vend mund të ndodhi eksperiencia e vendeve të tjera të BE, nga ku ne shtetin që është i sapol integruar, shtetas të tjerë mund të shfaqin interes për të punuar dhe për tu integruar në të.'

⇒ **Universiteti Europian i Tiranës**

U zhvillua në datë 2 Qershor debati mbi Integrimin Europian në Universitetin Europian të Tiranës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *'E ardhmja e Bashkimit Europian është zgjerimi, jo*

thellimi’, nën moderimin e Adela Danaj PhD (c), mentore dhe Anisa Curraj, koordinatorë projekti. Dy argumentet kryesore, mbi të cilat u përqëndrua ky debat, si më poshtë:

Skudra Pro- Rei Hodo (Student):

Është e kuptueshme që realiteti në të cilin po përballemi, ka bërë të mundur zvendosjen e shumë aspekteve. Sigurisht që procesi i zgjerimit është shumë i vështirë. Argumentet shpesh janë kokëfortë dhe zgjerimi e bënë këtë union dhe më të sigurt, procesi i zgjerimit të BE promovon Vlerat e Përbashkëta. Në tërësi procesi i zgjerimit është historik. Nisur nga ky fakt, për të kuptuar pse është i rëndësishëm zgjerimi, duhet të kuptojmë se përse Europa dhe Europianizimi është me rëndësi. Europa është më e sigurt falë projektit europian, sigurisht për ta konkretizuar rëndësinë dhe impaktin që ka procesi i zgjerimit që nis dhe përfundon, por ka disa etapa. Është e kuptueshme që aderimi është një process shumë i vështirë por i domosdoshëm. Duke zgjeruar sferën e analizës, besoj se zgjerimi është një nevojë imediate për BE.’

Skudra Kundër- Kristian Benusszi (Student):

‘BE nuk është organizatë gjeopolitike. Po ashtu duhet ta bëjmë në llogarinë në porpocion me shifrat. Mendoj se hapsira e lënë nga Mbretëria e Bashkuar është tepër e madhe. Po ashtu duhet të shohim kush do jenë aktorët kryesor pas largimit të Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Europian. Do duhet një kohë shumë e gjatë që shtete të reja të bëhen pjesë e BE, ndaj unë do doja të dija me cilën metodologji do duhet të adrerojnë këto shtete. Ne nuk jemi kundër zgjerimit por besojmë se në vitet në vijim Bashkimi Europian duhet të thellohet dhe jo zgjerohet.’

⇒ **Universiteti Luarasi**

U zhvillua në datë 3 Qershor debati mbi Integrimin Europian në Universitetin Luarasi. Skudrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *‘Lëvizja e lirë në Bashkimin Europian për të jetuar, për tu arsimuar dhe për të punuar do të shkaktojë krizë demografike në Shqipëri*’, nën moderimin e Dr. Dorina Gjipali, mentore dhe Megi Ruka. Debati u përshëndet dhe nga Prof. As. Dr. Anni Dasho, Zv. Rektore pranë Universitetit Luarasi. Në fjalën e tyre përshëndetëse Prof. Asoc. Dr. Anni Dasho dhe Dr. Dorina Gjipali, përgëzuan SCiDEV për iniciativën dhe ndër të tjera shtuan:

Prof. Asoc. Dr. Anni Dasho:

'Fakulteti ynë i Drejtësisë e ka pritur me entuziazëm pasi të tilla formate janë vlerë të shtuara për insitucionin tonë. Të tilla debate duhet të jenë pjesë e institucioneve akademike dhe paneleve universitare. Uroj që studentët do të mësojnë sa më shumë nga ky debat konstruktiv.'

Dr. Dorina Gjipali:

'Të menduarit kritik është tepër e domosdoshëme në këtë format debati, është një platformë shumë e mirë për studentin dhe aftësitë e tyre akademike dhe profesionale.'

Në lidhje me argumentët kryesorë mbi të cilat u trajtua debati mbi Integrimin European, studentët shtruan këto çështje për diskutim:

Kliti Gjoni (Student):

'Populli shqiptar ka një eksperiencë jo të gjatë migratore. Kriza demografike në vend është një situatë e pa evitueshme, vendi mbetet një nga shtetet më të vërfëra të Europës. Qytetarët tanë nuk mund të përballojnë katër nga nëntë kritëret bazike të jetesës, po ashtu 23.4% e popullësisë është e varfër krahasuar me vendet e tjera europiane. Norma jonë e papunësisë arrin në vlera tepër të larta bazuar në rezultatet e sondazheve të INSTAT. Kemi një largim të popullatës gjatë këtyre viteve. Niveli i besimit të popullatës është shumë i ulët, mungesa e stabilitetit politik dhe siguria juridike ndikon në emigrimin e qytetarëve. Të dhëna të tilla tregojnë që vendi vendi është në krizë demografike.'

Anxhela Kokoshi (Student):

'BE sot është një vend i lirë për të gjithë qytetarët antarë të këtij union. Kjo shprehet dhe në Traktatin e Manstritit dhe atë të Lisbonës. Sistemi i Bashkimit European është tashmë i unifikuar. Pas viteve 1990, vendi ka pësuar shumë ndryshime demografike, hapja e vendit drejt botës dhe kriza sociale dhe ekonomike solli interesin e qytetarëve drejt antarësimit në BE. Nuk duhet të harrojmë se fondet europiane ndihmojnë në avancimin e vendit. Vendi nuk mund të kalojë në një krizë tjetër demografike.'

⇒ **Fakulteti i Bisnesit, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës**

U zhvillua në datë 6 Qershor debati mbi Integrimin European në Fakultetin të Biznesit, Universiteti 'Aleksandër Moisiu' Durrës. Skuadrat pro dhe kundër debatuan mbi temën *'Anëtarësimi në BE sjell zhvillim ekonomik të vendit.'*, nën moderimin e Dr. Eldian Balla, mentor dhe Orkidea Xhaferaj,

eksperte e politikave publike. Dy skuadrat e përfshira në debat e përqëndruan debatin e tyre duke u mbështetur në argumentet e mëposhtme:

Skuadra Pro- Klaudia Xhepexhiu (Student):

'Konkurenca, eksporti, certifikimi dhe strukturimi i produkteve dhe shërbimeve janë thelbësore mbi diskutimin e sotëm. Integrimi në BE do ti sjell vendit rritje ekonomike, shërbime më të drejta dhe çmime më të favorshme. Nënshkrimi i marrëveshjeve sjell po ashtu përfitime për prodhuesit vendas dhe do të ndihmojë rritjen e eksporteve. Përfitimet e integrimit do të na vijnë në një periudhë afatgjatë, duke përfshirë investimet dhe orientimin e ekonomisë vendase kundrejt produkteve cilësore dhe me interes në treg.'

Skuadra Kundër- Rustem Selimaj (Student):

'Bie deri diku dakord me disa nga argumentet e parafolësve por unë jam kundër antarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Kjo sepse vendi ynë ende nuk është në nivelin e përshtatëshëm për të konkuruar vendet dhe produktet europiane. Eksporti sjell një efekt negativ, pasi dita ditës ne po importojmë gjithëmonë e më shumë produkte. Për zhvillimin ne kemi parësore si fushë buqësinë dhe po ashtu turizmin deri diku.'

Përfundimi dhe rekomandime

Ky dokument, hartoi në mënyrë të përmbledhur (i) prezantimin e projektit ‘Laboratori i debatit mbi integrimin europian në auditorët universitare’; (ii) qëllimin dhe objektivat e punimit; (iii) mekanizmat e përdorur për realizimin e tij gjatë periudhës së pandemisë COVID-19; (iv) ri-dimensionimin e SCiDEV për të realizuar turnamentin e debatit dhe përfshirë e SCiDEV në nisma të reja në kuadër të projektit por dhe kushteve të reja; (v) përmbledhje të elementeve kryesore të diskutuara gjatë zhvillimit të turnamentit sipas Universitetit/Fakultetit të përfshirë në projekt, sipas kategorive ‘Pro’ dhe ‘Kundër’.

Projekti arriti që të përforcojë tek studentët:

- mendimin kritik, kjo vihet re edhe në analizat dhe shkrimet e tyre për rubrikën Blog si edhe në nivelin e argumentave që paraqitën në debat;
- tolerancën për mendimin ndryshe që vihej re përgjatë të gjithë debateve;
- përmirësim të etikës së komunikimit dhe elementëve të lidhur me të;
- aftësitë kërkuese që vihet re në shqyrtimin e burimeve dhe raporteve të reja lidhur me COVID19 dhe BE-në.

Projekti tregoi mbi të gjitha është dëshmi e aftësisë së studentëve për tu përshtatur dhe ecur përpara (resilience), për tu treguar solidarë dhe për të mbështetur njëri tjetrin si edhe për të dhënë mesazhe ndërgjegjësuse për të tjetrët duke paraqitur edhe ide dhe zgjidhje inovative.

Debatet treguan që studentët dëshirojnë të angazhohen, të dëgjohen e të jenë pjesëmarrës, por kanë nevojë për mbështetje për akses, burime dhe zhvillim aftësie. Është me rëndësi zhvillimi i mëtejshëm i mendimit kritik, aftësisë kërkuese dhe analizuese si edhe përforcimi i etikës së komunikimit dhe tolerimit për mendimin ndryshe. Për ecurinë e demokracisë në vend, nevojiten të rinj të mirë-informuar dhe të angazhuar, ky projekti dha një kontribut, por ka edhe shumë nevoja në këtë drejtim.

Bazuar në këtë përvojë, rekomandohet për SCiDEV:

- ➔ të vazhdojë të mbështesë të rinjtë, studentët si edhe të tjerë grupe rinore me zhvillim aftësisë, rritje të kompetencave, ndërgjegjësim dhe përforcim të njohurive të tyre në çështje me rëndësi për zhvillimin social, ekonomik, politik dhe kulturor të vendit;

- të vazhdojë traditën e debatit universitar si një instrument për të nxitur mendimin kritik tek studentët, etikën në komunikim dhe tolerancën për mendimin ndryshe duke zgjeruar rrjetin e universiteteve partnere;
- të sigurohet që aktivitetet të jenë sa më gjithëpërfshirëse duke u kujtësuar për grupet rinore apo të rinjtë më pak të avantazhuar dhe duke lehtësuar hendekun digjital mes atyre që kanë akses, burime, aftësi dhe atyre që nuk i kanë;
- të promovojë modelet positive të të rinjve përmes mbështetjes së tyre, promovimit në universitetet dhe organizatat partnere, në rrjetet sociale, media dhe forma të tjera komunikimi;
- të nxisë të rinjtë që të jenë aktiv duke e zgjeruar rubrikën Blog dhe duke i dhënë zë studentëve dhe duke i pajisur me aftësi për të qenë qytetar aktiv dhe të angazhuar;
- të analizojë impaktin e COVID19 tek edukimi, mobiliteti dhe angazhimi i të rinjve;
- të dizenoj projektet së bashku me të rinjtë;
- të zgjerojë bashkëpunimin me partnerë të tjerë në shoqërinë civile, sektorin publik, media dhe atë privat për të fuqizuar të rinjtë dhe promovuar ata.

Rekomandime për politikëbërësit:

- të realizojnë bashkë-dizenjim të politikave me të rinjtë;
- të vazhdojnë dhe përforcojnë dialogun e strukturuar me të rinjtë sidomos për integrimin europian;
- të zbusin hendekun e botës digjitale mes të rinjve në situata të ndryshme social-ekonomike;
- të krijojnë hapësira pjesëmarrjeje dhe angazhimi për të rinjtë;
- të mbështesin iniciativat dhe nxisin punësimin dhe sipërmarrjen e të rinjve.

